

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 28.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Maja Damevska .

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 17:00 ora dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski njoftoi se në vazhdim do të shqyrtohet Pika 5 "Propozim-udhëzues për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024" e cila u shty për shkak të kërkesës për informata shtesë nga Kuvendi.

Z. Trajçevski shpjegoi se Këshilli i Agjencisë në seancën e kaluar ka miratuar Udhëzimin në Draft version. Agjencia e publikoi atë në ueb-faqen, dhe hapi debat publik në kohëzgjatje prej 5 ditsh, me mundësi për të gjithë palët e interesuara të paraqesin komentet dhe sugjerimet e mundshme lidhur me përmbajtjen. E vetmja parashtresë që u dorëzua ishte nga partia politike "E majta" me disa vërejtje, duke përfshirë - pse Agjencia me një Udhëzim rregullon reklamimin politik me pagesë për dy proceset e veçanta zgjedhore, presidenciale dhe parlamentare. Ai ka shpjeguar se kjo vërejtje nuk përputhet me praktikën e Agjencisë, sepse në zgjedhjet e kaluara Këshilli i Agjencisë kishte miratuar një Udhëzim dhe në të njëjtën kohë janë mbajtur zgjedhjet presidenciale dhe lokale në tri komuna. Gjithashtu, në dispozitat kalimtare të Udhëzimit, parashikohet që me konfirmimin e listave të kandidatëve për deputetë nga KSHZ-ja, Këshilli i Agjencisë me aneks do ta plotësojë këtë Udhëzim ku do të përcaktohen kushtet për RPP për pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare. Siç shpjegoi në seancën e kaluar, pas përfundimit të rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, do të miratohet aneks i tretë, përkatësisht një aneks i dytë i cili do të përcaktojë terminet për RPP në rrethin e dytë për dy kandidatët që do të marrin pjesë në zgjedhjet për kryetar të vendit. Lidhur me parashtresën se përveç kandidates Gordana Siljanovska Davkova, kandidatët e tjerë janë paraqitur në KSHZ jo si kandidatë të partive politike, por si kandidatë të grupi votuesish,

kryetari i partisë "E majta" kërkoi që pjesa tjetër e kohës të ndahet në mënyrë lineare midis të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, duke u thirrur në nenin që i referohet mënyrës së raportimit të transmetuesve gjatë fushatës zgjedhore. Në të njëjtin nen të Kodit Zgjedhor, thuhet se RPP-ja nuk hyn në pozicionet e Ligjit ku parashikohet raportim i balancuar ose i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Raportimi në emisionet informative është krejtësisht i ndryshëm nga RPP. Në hartimin e Draft-udhëzimit, morën pjesë aktive dhe Enti Shtetëror për Revizion, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Me këto institucione ASHMA-ja ka mbajtur dy takime të përbashkëta, dhe për shkak të papërcaktimit të ligjit, para dy ditësh Agjencia ka pasur një takim me përfaqësues të KSHZ-së për të sqaruar dilemat se cili pjesëmarrës në fushatën presidenciale në cilin grup të kohës së parashikuar për RPP duhet të përfshihet. Kishte paqartësi nëse partia politike GROM ka përfaqësues të saj në Kuvend dhe për këtë arsye i është dërguar shkresë e përbashkët me KSHZ-në dërguar kryetarit të Kuvendit dhe të njëjtën ditë, të martën, është pranuar shkresa nga Kryetari i Kuvendit, ku thuhet se partia politike GROM përfaqësohet në parlament me një deputet. Neni 75-gj nga KZ përcakton se partitë politike që në zgjedhjet e fundit nuk kanë fituar mandat të mjaftueshm për të formuar grup parlamentar, hyjnë në afatin kohor prej 60 sekondash, pra një minutë, dhe në përputhje me këtë udhëzim, dy kandidatët për zgjedhjet presidenciale, Biljana Vankovska dhe Stevço Jakimovski hyjnë në këtë grup të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, për të cilat koha maksimale e lejuar është një minutë në një orë reale. Po ashtu, qëndrimi i KSHZ-së ishte se nëse Kuvendi përgjigjet se partia politike GROM është e përfaqësuar në parlament, kandidati për president i asaj partie duhet të jetë në atë grup prej një minuti për RPP. Ai gjithashtu ka shpjeguar se nga Draft-udhëzimi në nenin 11 është fshirë pjesa e fundit e fjalisë, gjegjësisht janë fshirë fjalët "pavarësisht se kontratat për transmetim të RPP me transmetuesit do të lidhen nga partitë që ata mbështesin", sepse Agjencia është kompetente vetëm për përcaktimin e kohëzgjatjes për RPP dhe nuk ndërhyr në mënyrën e financimit të RPP. Në pikën 13 me kërkesë të Kryetarit të Këshillit shtohen fjalët "Në përputhje me nenin 76-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor".

Z. Petrushevski vuri në dukje se ka një gabim të vogël teknik në fillim të udhëzimit dhe sugjeroi që në dy vende të korrigohej datat "26.03.2024" , dhe në versionin përfundimtar që do të miratohet nga Këshilli të shkruhet "28.03.2024", sepse atëherë pika ishte anuluar dhe tani është miratuar. U tha se nuk ka komente të tjera në lidhje me tekstin.

Z. Fidanoski tha se ky është dokument që Këshilli është i obliguar ta miratojë si Agjenci, sepse rregullatori e udhëheq procesin e monitorimit, përfaqësimit të mediave gjatë zgjedhjeve. Agjencia, si edhe më parë, gjatë zgjedhjeve ka punuar plotësisht, profesionalisht dhe me përgjegjësi. Nga raportet e shumta që kanë dalë, organizatat dhe institucionet përkatëse ndërkombëtare konfirmojnë se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale e ka kryer punën e saj si duhet. Draft-udhëzimi që u vendos për diskutim publik shkaktoi interes tek palët e interesuara në këtë proces zgjedhor. Siç informoi drejtori Trajčevski, ka pasur një parashtesë dhe për atë parashtesë janë organizuar disa takime dhe ai personalisht ka marrë pjesë në disa prej tyre. Ai tha se në takimet e mbajtura është zbardhur dyshimi më i madh lidhur me ndarjen e kohës për RPP të kandidatët për president. Po ashtu, me aneks, siç është paralajmëruar, kur të konfirmohen listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare, dhe ky Udhëzim do të plotësohet lidhur me ndarjen e kohës për zgjedhjet parlamentare. Ajo që doli si dilemë për të cilën janë mbajtur takime të përbashkëta me KSHZ-në, si organi suprem për udhëheqjen e procesit zgjedhor, është lidhja me pikën 3 të Udhëzimit, e cila i referohet sa minutave shtesë në çdo orë aktuale të gjithsej 9 minuta dhe 30 sekondave

sa është e lejuar me ligj, do t'u ndahen kandidatëve për president. Ai shpjegoi se gjatë debatit publik ka shqyrtuar me kujdes Udhëzimin, duke e krahasuar me dispozitat ligjore dhe nuk ka dyshim se në shpërndarjen e kohës për kandidatët për president, në 4 minutat e para, ata hyjnë si kandidatë për president të Partive kushtimisht thënë të mbështetur nga partitë në pushtet Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani me maksimum 4 minuta, për dy partitë më të mëdha politike që në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më shumë vota të mbështetur nga opozita hyjnë Gordana Siljanovska Davkova dhe Arben Taravari. Ajo që theksoi “në zgjedhjet e fundit parlamentare” përshkon gjithë Ligjin dhe praktikisht, sipas tij, kjo është baza kur do të merret vendimi dhe përgjigja se pse një vendim i tillë me këtë propozim është i saktë. Kjo pasi që në rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare partia politike GROM ka deputetin e saj në Kuvend, logon si parti politike e përfaqësuar në parlament, e cila gjendet në ueb faqen e Kuvendit. Është dërguar Shkresë e përbashkët në KSHZ-në drejtuar Kuvendit për përgjigje, përgjigja është nënshkruar nga kryetari i Kuvendit dhe thuhet se “Ju njoftoj se një deputet në Kuvendin e RMV-së ka deklaruar se është i partisë politike Opsioni qytetar për Maqedoninë-GROM”. Nuk hyn në atë se sa ai deputet është aktualisht politikisht aktiv në parlament, kjo nuk është punë e tij. Personalisht, gjithmonë respektoj dispozitat e Ligjit, dhe neni 75 gj thotë se për partitë politike në Kuvendin e RMV-së që në zgjedhjet e fundit parlamentare nuk kanë fituar deputetë mjaftueshëm për të formuar grup parlamentar në zgjedhjet e fundit parlamentare, mund të ndajnë një minutë, e cila është ndarë sipas marrëveshjes së mëparshme të shkruar dhe pjesa e fundit e këtij paragrafi 1, sipas tij, sqaron edhe më shumë situatën dhe thotë: për partitë politike që nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë apo kandidatët, mund të ndajnë tridhjetë sekonda të cilat ndahen sipas marrëveshjeve së mëparshme me shkrim. Në këtë grup hyn vetëm kandidati i partisë politike ZNAM, Maksim Dimitrievski, për shkak se nuk janë fare të përfaqësuar në Kuvend, është formuar pas zgjedhjeve të fundit parlamentare. Potencion se Ligji thotë se ndarja bëhet në bazë të votave të fituara nga zgjedhjet e fundit, kurse ndarja e deputetëve nëse janë deklaruar, dhe si veprojnë është çështje krejtësisht tjetër. Sipas tij, kjo është çështje e veprimit politik, e punës së Këshillit është të respektojë Ligjin.

Z. Trajçev tha se pajtohet me z. Fidanoski se Ligji nuk përcakton qartë disa gjëra. Këshilli i ASHMA-së, në kuadër të praktikës së mëparshme dhe mënyrës se si zbatohet ligji, duhet të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për ta shprehur atë në mënyrën më korrekte dhe t'u përmbahet në mënyrë rigorozë dispozitave të parashikuara në ligj, edhe pse disa prej atyre dispozitave mund të mos jenë plotësisht të qarta në kuptim të interpretimit. Lidhur me procedurën aktuale, ka një parashitje nga partia politike e Majtë që është dorëzuar zyrtarisht për Draft Udhëzues, ku i referohet 5 pikave. Ai i falënderoi për parashitjen dhe tha se disa nga argumentet që i kanë dhënë janë të vlefshme, disa jo, dhe në këtë drejtim tha se do të japë mendimin e tij për të gjitha pikat e cekura në parashitje. Në pikën e parë theksojnë se ligjërisht dhe nomoteknikisht është më mirë të ketë dy Udhëzime. Megjithatë, sipas praktikës së Agjencisë, është sjellë një udhëzim. Për të nuk është aspak e rëndësishme nëse do të ketë një apo dy udhëzime sepse në thelb ky udhëzim do të përfshijë të dy elementët, zgjedhjen e presidentit dhe zgjedhjen e deputetëve dhe në vetë udhëzimin thuhet se Aneksi do të përcaktojë të gjithë procedurën në pjesën e zgjedhjes së deputetëve kur konfirmohen nga KSHZ-ja. Për pikën 1, nga aspekti juridiko formal, ai nuk sheh arsye që duhet të ketë dy udhëzime, mund të jetë një. Në lidhje me pikën e dytë ku referohen parimet juridike, konkretisht neni 75-a, paragrafi (1), pika a e Kodit Zgjedhor, ku thuhet se për Zgjedhjet Presidenciale është e vlefshme parimi bazë i paprekshmërisë i të gjitha kandidatëve dhe parimi i proporcionalitetit në zgjedhjen e deputetëve. Kjo është e saktë në vetë nenin, por në të njëjtin

nen, paragrafi (3), nëse e lexoni, do të shihni se në të njëjtin nen, ligjvënësi ka parashikuar që parimi i proporcionalitetit, pra barazisë, e përjashton RPP-në, që tregon se këto dy parime nuk zbatohen për RPP, referohen parimeve të parashikuara në nenin 75 gj, dhe këto parime i referohen raportimit të përgjithshëm të medias për fushatën politike. Por për RPP-në i referohet nenit 75 gj, ku po të lexoni dhe në vetë nenin do të shihni se gjatë fushatës zgjedhore si në rrethin e parë ashtu edhe në atë të dytë të votimit, sepse rreth të dytë votimi ka vetëm në zgjedhjen e kryetarit dhe zgjedhja e kryebashkiakut dhe në vetë ankesën që kanë dhënë, duan të thonë se kjo pjesë nuk duhet të zbatohet në mënyrën e përcaktuar në minuta. Vetë neni thotë se kjo zbatohet në rastin e zgjedhjes së presidentit. Pra, mënyra e shpërndarjes së minutave nuk shkon sipas principit të cekur RPP, kjo referohet në nenin 75 dhe paragrafin 3, ajo ndjek parimin e përcaktuar në 75 gj, ku është shprehur qartë dhe pa mëdyshje janë cekur minutat për secilin prej kandidatët që mund të përdorin si numër maksimal të minutave në RPP, gjë që nuk vlen fare për mënyrën tjetër të informimit. Për sa i përket pikës së tretë të kundërshtimit, ata vetë konkludojnë se është absurd neni sipas mënyrës se si e interpretojnë, po nëse shkohet në faktin se një grup votuesish të gjithë kandidatë përveç një kandidati. Nëse shkohet në mënyrë strikte ashtu siç është, ata dhe vetë thonë se të 6 kandidatët do të ndajnë vetëm 30 sekonda në eterin e transmetim, gjë që nuk është aspak qëllimi kështu që ligjvënësi, për arsye që në rastin dhe në udhëzimet tona nuk flasim se kush është parashtruesi i listës, pra kandidati, por po flasim se kush e ka mbështetur dhe cilin kandidat. Kështu thuhet në vetë udhëzimin se e mbështetur nga partia, dhe kjo e shtjellon të drejtën e minutave që merr. Sa i përket pikës 4, ai pajtohet absolutisht me këtë pjesë dhe i falënderon për atë që kanë theksuar, sepse Udhëzuesi nuk mund të rregullojë mënyrën se si do të lidhen këto kontrata, si do të paguhen, kjo nuk është fare punë e Agjencisë. Dhe në zgjedhjet e mëparshme, kur u zbatua Udhëzuesi, rreptësisht u tha se nuk është e jona të ndërhyjmë në mënyrën se si do të bëhet pagesa. Është mirë që me pikën 4 theksuan dhe tashmë në propozimin e ri të Udhëzimit, pika 11 është ndryshuar plotësisht dhe nuk është përfshirë fare ajo që ishte në udhëzimin e mëparshëm. Ndryshe, me të drejtë theksojnë se partitë politike nuk mund të lidhin marrëveshje, me të drejtë theksojnë se ka një xhiro llogari të veçantë të destinuar ekskluzivisht për kandidatin dhe se vetëm përmes asaj llogarie mund të bëhen pagesa, që është absolutisht e drejtë, por kjo nuk është kompetencë e Këshillit të Agjencisë, kjo është kompetencë e KSHZ-së. Na takon vetëm ne të përcaktojmë ndarjen e minutave. Sa i përket pikës 5, aty janë dy elementë, njëri është kandidati Arben Taravari dhe tjetri Stevço Jakimovski. Për Arben Taravarin, pas shkresës nga Kuvendi, qëndrimi i tij i parë analiza e parë ka qenë në mënyrë të njëjtë siç përcaktohet në Udhëzim se nuk ka deputet, por kur erdhën argumentet në drejtim të kundërt, kur u mbajt takimi me KSHZ-në, ku ka qenë dhe drejtori Trajçevski dhe anëtarë të Këshillit dhe ku është biseduar për këtë çështje, në veçanti pas ardhjes së shkresës nga Kuvendi, se një deputei nga GROM ka në Kuvend. Po të shikosh vetë nenin që i referohet 75-gj, që rregullon minutat, ku janë dy grupe, shihet qartë opozita dhe qëndrimi, por në pjesën e dytë thuhet: .. për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë që nuk kanë fituar deputetë të mjaftueshëm për të formuar grup parlamentar në zgjedhjet e fundit parlamentare, mund të marrin një minutë në këtë rast partia politike në Kuvend ka fituar një deputet dhe ka një deputet. . Edhe pse fillimisht mendonte se kishin të drejtë në atë pjesë, në pikën 5 që i referohet Stevço Jakimovskit, pas këtyre shkresave, pas takimit që kanë pasur me KSHZ-në, ueb-faqen, e veçanërisht shkresa e Kuvendit të nënshkruar nga kryetari i Kuvendit, askush nuk mund ta interpretojë atë ndryshe vetëm si është përcaktuar në Udhëzim. Edhe një herë i falënderoi për parashtresën që e kanë dorëzuar, në këtë drejtim janë mbajtur takime me Agjencinë dhe është dorëzuar shkresë nga Kuvendi, në mënyrë që të miratohet Udhëzuesi aktual, që është i vlefshëm dhe i përshtatshëm për zbatimin e ligjit.

Z. Fidanoski shprehu mirënjohje për parashtesën, i cili u mundësoi të shqyrtojnë më hollësisht Udhëzimin, të bëjnë konsultime në shumë nivele, dhe tashmë është thënë nga drejtori Trajçevski dhe z. Trajçev, falë parashtesës po sjellin Udhëzues të qëndrueshëm që do t'i përgjigjet sfidës së përfaqësimit të medias gjatë procesit zgjedhor. Ai tha se po të ishte në dorën e tij, nuk do të kishte fare RPP në LZ, ky është qëndrimi i tij, kjo duhet të shkojë në shërbimin publik pa pagesë. Por tani ligjvënësi ka vendosur që të ketë RPP ashtu siç është në LZ dhe kjo sigurisht që duhet respektuar.

Z. Petrushevski tha se ASHMA-ja prej disa vitesh ka dhënë mendimin se nuk është mirë të ketë RPP, sidomos nga buxheti, këtu në atë pjesë ai e përkrah, por nuk varet nga Agjencia, varet nga Kuvendi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Udhëzimin për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, me tekstin e propozuar.

Udhëzimi për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024 do t'u dërgohen transmetuesve.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe të Këshillit, Udhëzimin e mësipërm për transmetuesit për Ugdhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pas votimit, z. Petrushevski u dëshiron të gjithë kandidatëve luftë cilësore dhe interesante, diskutime të mira dhe në fund qytetarët të zgjedhin ashtu siç mendojnë se është më mirë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**